



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 455 Prot.

Tiranë, më datë 01.11.2019

VENDIM

Nr. 377, datë 01.11.2019

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Neni 83, Neni 278 dhe Rregullores miratuar me Vendim KKR-je Nr.58, datë 10.01.2018 “Mbi kriteret dhe procedurat administrative, për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, në mbledhjen e datës 01.11.2019 Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, pasi shqyrtoi kërkesën e Shoqërisë “AD - STAR” sh.p.k,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “AD STAR” sh.p.k. me licensë në fushën e restaurimeve (R.SH.37), me drejtues ligjor z. Alfred Çoma, për të shtuar si drejtues teknik: z.Alfred Çoma, i pajisur me licensë (R.P. 62) dhe (R.P.63) në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës në projektim dhe zbatim dhe z. Uliam Çikopano, i pajisur me licensë (R.P.13) në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale për kategorinë (B/1);
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, shtimin e drejtuesve teknik në licensën e fushës së restaurimit për shoqërinë “AD STAR” sh.p.k. me drejtues teknik restaurator z.Alfred Çoma dhe z. Uliam Çikopano;
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Elva MARGARITI

SEKRETAR I KKR

Arta Dollani

